


01-2506



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 57 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 Për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391-311912 dt. 22.12.2016, të kërkuësve / bashkëpronarëve, Hadije Mahmutaj, Litafete Ponosheci, Meliha Faiku, Sylejman Daka, Abdylreshid Daha, Adnan Daka, Zade Bakir, Ismet Bajrami dhe Sabit Haxhikurteshi nga Prishtina, dhe Investitor “Kosova Group LLC” sh.p.k. me seli në Prishtinë, rr. “Bajram Kelmendi”, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, e ndërtuara, në kuadër të bllokut “I” dhe “D”, të Planit Rregullues “Dodona”, në rr. “Halim Spahia” dhe “Bajram Kelmendi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt juridiko-administrative, me datë 14.08.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. MIRATOHET** kërkesa 05 Nr. 391/02-142442/23 dt. 10.07.2023, e parashtruar nga aplikuesit Hadije Mahmutaj, Litafete Ponosheci, Meliha Faiku, Sylejman Daka, Abdylreshid Daha, Adnan Daka, Zade Bakir, Ismet Bajrami dhe Sabit Haxhikurteshi nga Prishtina, me Investitor “Kosova Group LLC” sh.p.k., me seli në Prishtinë me numer të biznesit 811125857, për heqjen e Vendimit të Pezullimit 09 Nr. 391-311912 të datës 23.09.2019.
- II. SHFUQIZOHET** Akti Administrativë “Vendim për Pezullimin e Procedurës Administrative”, me numër 09 Nr. 391/02-311912 të datës 23.09.2019.
- III. I LEJOHET** kërkuësve / bashkëpronarëve Hadije Mahmutaj, Litafete Ponosheci, Meliha Faiku, Sylejman Daka, Abdylreshid Daha, Adnan Daka, Zade Bakir, Ismet Bajrami dhe Sabit Haxhikurteshi nga Prishtina, dhe Investitor “Kosova Group LLC” sh.p.k., me seli në Prishtina me numër të biznesit 811125857, ku sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-311912 dt. 22.12.2016, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “Ndërtesës 1” me etazhitet 2B+P+7, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351-13895 dt. 21.10.2013, në parcelën kadastrale nr. 10585-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10585-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “I” dhe “D”, të Planit Rregullues “Dodona”, në Prishtinë.
- IV.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Halim Spahia” ku ka dalje hyrjet me numrin: 45, dhe në rrugën “Bajram Kelmendi” ku ka dalje hyrjet me numrat: 33, 35, 37, 39, 41, 43, 45, 47 dhe 51 në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- V.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrimit kadastral.
- VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Hadije Mahmutaj, Litafete Ponosheci, Meliha Faiku, Sylejman Daka, Abdylreshid Daha, Adnan Daka, Zade Bakir, Ismet Bajrami dhe Sabit Haxhikurteshi nga Prishtina, dhe Investitor “Kosova Group LLC” sh.p.k., me seli në Prishtina me numer të biznesit 811125857, me kërkesën 05 Nr. 391-311912 dt. 22.12.2016, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+7, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “I” dhe “D”, të Planit Rregullues “Dodona” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10585-0, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351-13895 dt. 21.10.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit, e Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-311912 dt. 06.11.2018, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1. Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1. Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2. Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c. Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d. Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3. Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4. Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Fitnete Shala/Arben Isahu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Burim Smajli; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësllësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Fadil Balaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve eklektike, nga mbikëqyrësi Agan Lezi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Faton Behrami; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Hamit Basholli me nr. të licensës 132;

Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas kësaj kërkesës, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe provave të bashkëngjitura, ka konstatuar se:

- Aplikuesit me kërkesën 05 Nr. 391-311912 dt. 22.12.2016, fillimisht kanë kërkuar nga kjo drejtori pranimin teknik të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa "Ndërtesës 1" me etazhitet 2B+P+7, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351-13895 dt. 21.10.2013, në parcelën kadastrale nr. 10585-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10585-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban "I" dhe "D", të Planit Rregullues "Dodona", në Prishtinë. Ne procedure të shqyrtimit të kërkesës, kjo drejtori, me shkresën "Aktpërcjellës" 05 Nr. 391-311912, dt. 22.12.2016, të datës 28.12.2016, bazuar në nenin 29, të Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 18/2013, kjo çështje bie në kompetencën e Inspeksionit Ndërtimor të Komunave, andaj konform neneit 18, pika b), të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 02/L-28, kërkesën në fjalë e ka përcjellë në kompetencë në Drejtorinë e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit, për shqyrtim të mëtejme.
- Drejtoria e Inspeksionit, përmes shkresës zyrtare 05 Nr. 391-311912 dt. 06.11.2018, ka prezantuar Raportin e Inspektimit Final.
- Me shkresën "Plotësim dokumentacioni" 09 Nr. 391/02-311912/18, dt. 29.11.2018, është kërkuar nga aplikuesi që të prezantohet dokumentacioni sipas shtojcës numër 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017: Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01. (të jetë konform kërkesave ligjore të kadastrit); Dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë; Protokollat e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve; Nëse janë bërë modifikime gjatë ndërtimit, duhet të dorëzohet "PROJEKTI I NDËRTIMIT TË REALIZUAR" që në mënyrë specifike tregon modifikimet.
- Aplikuesit, me kërkesën 09 Nr. 391/02-311912/16/3, dt. 06.12.2018, "Plotësim dokumentacioni", kanë prezantuar dokumentacionin sipas shtojcës numër 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar është konstatuar se nuk është bërë bashkimi i parcelave kadastrake nr. 5636-1, 5637-2, 5635-3, 5634-4, 5634-3 dhe 5633-2, ZK Prishtinë, andaj kjo drejtori përmes shkresës "Pëlqim për bashkim të parcelave kadastrale nr. 5636-1, 5637-2, 5635-3, 5634-4, 5634-3 & 5633-2 ZK Prishtinë", me numër të protokollit 09 Nr. 391/02-311912 dt. 10.12.2018 ka dhënë pëlqimin për bashkimin e parcelave kadastrale të lartshënuara.
- Aplikuesit, pas fillimit të procedurës për bashkimin e parcelave kadastrale, në hapësirat zyrtare të kësaj drejtorie, kanë njoftuar në mënyrë verbale se procedura për bashkimin e parcelave nuk mund të realizohet shpejtë, andaj me aktin "Vendim për Pezullimin e Procedurës Administrative", me numër 09 Nr. 391/02-311912 të datës 23.09.2019, është pezulluar procedura e vendosjes së çështjes administrative të lartcekur.

- Ashtu që, aplikuesit përmes shkresës zyrtare "Plotësim lënde", me nr. 05 Nr. 391/02-142442/23 të datës 10.07.2023, kanë njoftuar këtë drejtori se është bërë bashkimi i parcelave kadastrale, duke u formuar parcela kadastrale me nr.10585-0 Zona Kadastrale Prishtinë, duke prezantuar edhe dëshminë mbi pronësinë për parcelën e njëjtë.

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacion ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-311912 DT. 14.08.2023**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

Drejtori,
Arbes Sadiki



